




# EDUKIMI MJEDISOR



maj 2024

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshin studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

**“Mirësia e natyrës kuptohet kur gjen për të mësuar kudo që ndodhesh”**  
**Leonardo da Vinçi**

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes kësaj përmbledhjeje mujore Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, përgjatë muajit shkurt 2023, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin; atyre që ndodhen pranë ZM-ve, në zonat rurale. Aktivitete janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **810**

Specialistë të angazhuar **20**

Orë mjedisore të realizuara **54**

**54** Shkolla të përfshira

**54** Mësues të përfshirë

# “EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



## 10 maj 2024, orë mjedisore për pelikanin kaçurrel

Specialistët e AdZM Shkodër zhvilluan një orë mjedisore për shkollën 9-vjeçare "At Gjon Karma" për pelikanin kaçurrel. Gjatë kësaj ore nxënësit mësuan mbi vlerat dhe të veçantat e kësaj specie, e cila njihet ndryshe si një ndër shpendët më të mëdhenjë në Evropë. Nxënësit kuptuan rëndësinë që ka çdo krijesë në ekosistem, rëndësia e mbrojtjes së tyre dhe të habitateve ku ato jetojnë.

## 22 maj 2024, Ditës Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Zhvilluam një orë mjedisore me nxënës të shkollës 9-vjeçare "Tonç Gjon Toma" në Rragam. Së bashku me nxënësit e kësaj shkolle folëm për zonat e mbrojura dhe oazet e biodiversitetit që ato krijojnë në vend. Nxënësit mësuan më shumë për rëndësinë e biodiversitetit në tërësi dhe specifikisht mbi rëndësinë e ditës dedikuar atij.

pelikani kaçurrel

biodiversiteti në Shqipëri

# “EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



## 08 maj 2024, flora dhe fauna në Alpe

Në kuadër të edukimit mjedisor me shkollat, specialistët e AdZM-së Kukës realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9 vjeçare “Dragobi” për florën dhe faunën e Parkut Kombëtar “Alpet e Shqipërisë” dhe rëndësinë e ruajtjes së tij.

## 22 maj 2024, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Në kuadër të kësaj dite specialistët e AdZM-së Kukës realizuan një orë mjedisore në natyrë me nxënësit e shkollës së mesme “Shishtavec” brenda Parkut Natyror “Korab-Koritnik”. Gjatë ecjes në natyrë ata u njohën me biodiversitetin e Parkut Natyror “Korab-Koritnik” si dhe kujdesin që duhet të kemi gjatë eksplorimit të natyrës; vizituan parkun e aventurës Shishtavec dhe realizuan ecje në natyrë. Në këtë mënyrë ne mund të arrijmë të ndërgjegjësojmë nxënësit dhe brezat e ardhshëm mbi vlerat dhe rëndësinë që ka biodiversiteti në Zonat e Mbrojtura dhe jo vetëm.

## 24 maj 2024, Dita Botërore e Parqeve

Në kuadër të kësaj dite stafi i AdZM-së Kukës së bashku me një grup nxënësish të shkollës mesme “Asim Vokshi” B. Curri realizuan një ecje në natyrë në shtegun turistik “Dragobi-Valbonë” brenda Parkut Kombëtar të Alpeve të Shqipërisë. Parku Kombëtar “Alpet e Shqipërisë” është parku më i madh në vend i cili kohët e fundit është kthyer në destinacionin e preferuar ekoturistik për vizitorët vendas dhe të huaj.

## 29 maj 2024, monumentet e natyrës

Në kuadër të edukimit mjedisor me shkollat, stafi i AdZM-së Kukës zhvilloi një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Krume”. Nxënësit u njohën me monumentet e natyrës që ka në zonën e Hasit dhe kujdesi që duhet treguar në mbrojtjen e tyre. Gjithashtu u fol për florën dhe faunën në këtë zonë dhe në përfundim nxënësit realizuan vizatime për konceptet e reja që ata mësuuan, pasi krijimi është një formë shumë e mirë për të mësuar.

ecje në natyrë

monumentet e natyrës

biodiversiteti

alpet e Shqipërisë

destinacion ekoturistik



# “EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



## 10 maj 2024, Dita Kombëtare e Pelikanit Kaçurrel

Bashkë me nxënësit e shkollës 9 - vjeçare "Fran Ivanaj" zhvilluam një orë mjedisore në kuadër të Ditës Kombëtare të Pelikanit Kaçurrel. Nxënësit u njohën me habitatin ku rriten pelikanët dhe me kushtet që duhet të ofrojë habitatin ku këta shpend rriten, rëndësia e këtij shpendi në ekosistem, mënyrat e numërimit të shpendëve dhe pse i numërojmë ato. Të mbrojmë mjedisin ku jetojnë pelikanët dhe rëndësia e këtij shpendi në ekosistem ishte mesazhi i përçarur tek nxënësit nëpërmjet kësaj ore mjedisore.

## 13 maj 2024, Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë është një fushatë vjetore e ndërgjegjësimit që vë në dukje nevojën për ruajtjen e zogjve migrues dhe habitateve të tyre. Ajo ka një shtrirje globale dhe është një mjet efektiv për të ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit global për kërcënimet me të cilat përballen zogjtë migrues, rëndësinë e tyre ekologjike dhe nevojën e bashkëpunimit ndërkombëtar për t'i ruajtur ata. Së bashku me nxënësit e shkollës 9 - vjeçare "Nikë Tome Prela" Gorre zhvilluam orë mjedisore ku prezantuam disa nga shpendët shtegtarë. Mesazhi i përçarur tek nxënësit ishte rëndësia e ruajtjes dhe rivitalizimit të lidhjes ekologjike dhe integritetit të ekosistemeve, që mbështesin lëvizjen natyrore të shpendëve shtegtar dhe që janë thelbësore për mbijetesën dhe mirëqenien e tyre.

## 22 maj 2024, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Specialistët e AdZM-së Lezhë së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Gjovalin Gjadri" zhvilluan një aktivitet mjedisor, përmes të cilit paraqitëm biodiversitetin e Zonave të Mbrojtura, përgatitëm postera dhe zhvilluam lojëra të ndryshme në natyrë. Qëllimi i kësaj ore mjedisore ishte të risim ndërgjegjësimin për biodiversitetin e pasur të Zonave të Mbrojtura dhe, indirekt të ndikojmë përmes nxënësve tek prindërit, të afërmit dhe miqtë e tyre.

zogjtë migrues

numërimi i shpendëve

rivitalizim ekologjik

mirëqenia e shpendëve



# “EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



## 10 maj 2024, Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Specialistët e AdZM-së Tiranë realizuan një orë mjedisore në kuadër të kësaj dite ndërkombëtare së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Ballaj" të klasave të 4, 6, 7, 8 dhe 9-ta. Nxënësit u njohën me llojet e ndotjes, problemet që sjell ndotja në shëndetin e njerëzve dhe organizmave të tjera. Gjatë bashkëbisedimit nxënësit mësuuan, se cilët janë ata faktorë që na çojnë në shtimin e ndotjes. Nëpërmjet disa pyetjeve të bëra nga ne në formën e ushtrimit nxënësit dhanë disa ide për mënyrat që na ndihmojnë në parandalimin e ndotjes së mjedisit. Në fund me shumë dëshirë ata dhanë disa mesazhe të ndërlidhura me vizatime, që ndihmojnë në mbrojtjen dhe kujdesin ndaj mjedisit (tokë, ujë ajër). Kjo orë mjedisore kishte si qëllim dhënien e mesazhit "Secili nga ne duhet ta ruaj dhe përdor me kujdes mjedisin, pasi ai është burimi kryesor i jetës në Tokë".

## 22 maj 2024, Dita Botërore e Biodiversitetit

Së bashku me nxënësit e shkollës së mesme të Bashkuar "Ymer Lala", Surrel, u realizua një orë mjedisore në natyrë. Nxënësit përgatitën disa korniza arti të natyrës dhe më pas me ndihmën e bimëve të gjetura në natyrë krijuan disa imazhe të mrekullueshme. Ndërkohë gjatë aktivitetit nxënësit u kthyen dhe në eksplorues të natyrës. Kjo orë mjedisore kishte si qëllim dhënien e mesazhit "Harmonia që duhet të kemi me natyrën", pasi nëpërmjet saj ne mund të arrijmë zgjidhjen e shumë çështjeve që kanë të bëjnë me shëndetin tonë, ujin, ushqimin, bimët mjekësore.

## 24 maj 2024, Dita Evropiane e Parqeve

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Tufinë", Surrel vizituan qendrën e vizitorëve në Parkun Kombëtar "Mali i Dajtit" ku u njohën me vlerat e parkut, fituan njohuri rreth biodiversitetin si flora dhe fauna, burimet ujore, shtigjet, monumentet e natyrës, si dhe shprehën dëshirën dhe përshkuan shtegun "Kalaja e Dajtit" ku u mrekulluan nga bukuria e peizazhit dhe ajri i freskët që dhuronin pyjet e ahut. Kjo orë u realizua në natyrë me qëllim për të rritur ndërgjegjësimin e të rinjve mbi vlerat dhe rëndësinë e bukurive natyrore, duke ruajtur zonat e mbrojtura dhe parqet natyrore.

eksplorues të natyrës

zona të mbrojtura

dita e biodiversitetit

peizazhe natyrore

bimë mjekësore





# “EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



## 10 maj 2024, Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Zhvilluam një orë mjedisore në kuadër të kësaj dite, me nxënësit e shkollës 9- vjeçare "Jubë" në Rrushkull. Fillimisht nxënësit u njohën shkurtimisht me zonat e mbrojtura të qarkut Durrës dhe rëndësinë që ka Dita Ndërkombëtare e Zogjve Migrues. Përmes materialeve ilustruese nxënësit u njohën me llojet kryesore të shpendëve migratore të vendit tonë. Lagunat bregdetare dhe liqenet e vendit tonë janë vendbanime të rëndësishme që ofrojnë kushtet e nevojshme, veçanërisht për dimërimin e shpendëve migratore. Nxënësit kuptuan kujdesin e madh që duhet të tregojmë për mjedisin, për të mos ndërhyrë në habitatet dhe ekuilibrat natyrorë.

## 15 maj 2024, Dita Ndërkombëtare e Ndryshimeve Klimatike

Specialistët e AdZM-së Durrës zhvilluan një orë mjedisore tepër interesante me nxënësit e shkollës 9 –vjeçare "Zenel Tepshi " në Krujë. Nxënësit e klasës së 4-t të kësaj shkolle fillimisht u informuan mbi termin "Ndryshimet Klimatike", shkaqet që kanë favorizuar këto ndryshime si edhe pasojat më të cilat ne sot përballemi si pasoj e këtyre ndryshimeve në atmosferë. Në përfundim të orës informues, së bashku me nxënësit u realizua një demonstrim mbi çlirimin e gazeve ndotës në atmosferë. Për të kuptuar më shumë përbërjen e ajrit zhvilluam eksperimentin me acid acetic (uthull) me bikarbonatin e sodiumit (sodë buke). Nga ky reaksion kimik  $\text{NaHCO}_3 + \text{HC}_2\text{H}_3\text{O}_2 \rightarrow \text{NaC}_2\text{H}_3\text{O}_2 + \text{H}_2\text{O} + \text{CO}_2$  do të çlirohet në atmosferë  $\text{CO}_2$ . Ky aktivitet do të shërbejë për të ofruar njohuri për nxënësit mbi nivelet e dioksidit të karbonit, ndikimin në ambientin tonë, dhe rëndësinë pse duhet të jemi të kujdeshëm me burimet natyrore. Nxënësit u treguan tepër bashkëpunues në zhvillimin e eksperimentit.

ekuilibrat natyror    gaz ndotës    reaksion kimik  
shpend shtegtarë    shpend migratorë    reaksion kimik



## **22 maj 2024, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit**

Specialistët e AdZM-së Durrës zhvilluan një orë mjedisore së bashku me nxënësit e shkollës 9 - vjeçare " Xhelal Shtufi" në Shkafan. Fillimisht nxënësit u njohën me simbolikën e kësaj dite ndërkombëtare dhe rëndësinë që ka kjo ditë dhe çështjet kryesore që lidhen me biodiversitetin. Nxënësit u njohën me llojet më të përhapura të specieve që gjenden në zonat e mbrojtura nëpërmjet materialeve të mundësuar nga specialistët tanë. Biodiversiteti është ai që bën të mundur zhvillimin e jetës në planetin tone, ndaj ruajtja e tij është e rëndësishme dhe e domosdoshme për vazhdimësinë e jetës.

---

## **27 maj 2024, orë mjedisore**

Specialistët e AdZM-së Durrës realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9- vjeçare e " Xhelal Shtufi" Shkafane në Durrës. Në fokus të kësaj ore mjedisore u trajtuan çështjet kryesore rreth ndotjes së mjedisit, çfarë i shkakton dhe si mund të marrim masa për ndalimin e ndotjeve. Në përfundim nxënësit realizuan poster me vizatimeve të ndryshme, të cilët përcjellin mesazhe shumë të rëndësishme për mënyrën se si duhet të sillemi ne në mjedisin ku jetojmë.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



## 15 maj 2024, Dita Ndërkombëtare e Ndryshimeve Klimatike

Specialistët e AdZM-së Elbasan, në bashkëpunim me nxënësit e Shkollës së Mesme "Ahmet Elezi", në afërsi të Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Stravaj-Sopot", realizuan një orë mjedisore, në kuadër të "Ditës Ndërkombëtare të Ndryshimeve Klimatike". Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me faktorët që ndikojnë në ndryshimet klimatike, ndryshime të cilat vitet e fundit janë kthyer në një fenomen dhe dëmet kanë nisur të shfaqen në të gjithë rruzullin tokësor, siç janë ngrohja globale, thatësira etj. Në përfundim u realizua një bashkëbisedim midis specialistëve dhe nxënësve ku nxënësit treguan interesin e tyre për të dëgjuar dhe marrë sa më shumë informacion, duke bërë pyetje dhe treguar kuriozitete të ndryshme.

## 16 maj 2024, aktivitet pastrimi me nxënësit e shkollës "Shefqet Dosku"

Në bashkëpunim me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Shefqet Dosku" Dorëz, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik", u realizua një aktivitet mjedisor, siç është ai i pastrimit. Nxënësit e realizuan këtë aktivitet në ambientet e shkollës dhe zonës rreth saj, duke u informuar për faktorët dhe problemet e ndryshme që shkakton ndotja, si dhe masat që duhet të marrin për kujdesin dhe mbrojtjen e mjedisit. Së bashku me dëshirën dhe vullnetin e nxënësve arritëm të rikthenim ambientin e ndotur në një mjedis të pastër dhe të këndshëm për të qëndruar.

park kombëtar ndërgjegjësimit vlera natyrore edukim mjedisor

aktivitet mjedisor ndryshime klimatike aktivitet pastrimi mjedis i pastër



## **21 maj 2024, aktivitet pastrimi me nxënësit e shkollës “Veiz Çota”**

Në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Veiz Çota”, Togëz, në afërsi të Parkut Kombëtar “Shebenik”, specialistët e AdZM Elbasan realizuan një aktivitet mjedisor. Nxënësit realizuan aktivitet pastrimi në ambientet e shkollës dhe zonës rreth saj, duke u informuar për problemet që shkakton ndotja.Pogradecit.

---

## **22 maj 2024, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit**

Në Ditën Ndërkombëtare të Biodiversitetit, specialistët e AdZM Elbasan ishin me nxënësit e shkollës së mesme të Bashkuar "Isak Alla" Zgost për të diskutuar dhe ndarë me ta informacione rreth kësaj teme të gjerë, siç është dhe biodiversiteti. Një tjetër temë, e cila u diskutua me nxënësit, ishte realizimi i një herbariumi dhe hapat që duhen ndjekur deri në përfundim të rezultatit të dëshiruar. Specialistët paraqitën para nxënësve një material me disa herbariume, të cilët ishin krijuar për ta. Të kujdesemi për natyrën dhe zonat e mbrojtura dhe të mos i dëmtojmë pasuritë natyrore të zonës sonë, ishte mesazhi i përçuar tek nxënësit gjatë kësaj ore mjedisore.

---

## **30 maj 2024, promovimi i vlerave mjedisore**

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare Librazhd Katund, pjesë e Parkut Kombëtar “Shebenik”. Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me vlerat natyrore dhe mjedisore të parkut si dhe me florën e faunën e kësaj zone të mbrojtur, nëpërmjet prezantimit të materialit të përgatitur paraprakisht nga specialistët. Në përfundim të kësaj ore mjedisore nxënësit arritën të identifikonin me sukses llojet më të përhapura të bimëve dhe të kafshëve që gjenden në park. Kështu mund të arrijmë të ndërjegjësojmë brezat e rinj mbi rëndësinë që ka ruajtja e biodiversitetit në zonat e mbrojtura dhe jo vetëm.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



## 10 maj 2024, Dita Botërore e Pelikanit kaçurrel

AdZM Dibër realizoi një orë mjedisore në kuadër të ditës botërore të Pelikanit kaçurrel, me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Irfan Hajrullai”. Nxënësit u njohën me Pelikanin kaçurrel, habitatin dhe kërcënimet ndaj tij. Në fund nxënësit u ndanë në dy grupe duke plotësuar ushtrime të ndryshme në lidhje me njohuritë që morën gjatë kësaj ore mjedisore.

## 10 maj 2024, shpendët shtegtarë në vendin tonë

Në kuadër të Ditës Botërore të Shpendëve Shtegtarë, AdZM Dibër realizoi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9 – vjeçare “Idriz Kaba”. Përmes vizatimeve dhe lojërave, nxënësit mësuuan fakte interesante për llojet e shpendëve shtegtarë.

## 17 maj 2024, Dita Botërore e Ndryshimeve Klimatike

AdZM Dibër, në kuadër të Ditës Botërore të Ndryshimeve Klimatike realizoi sot një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Selim Alliu”. Specialistët ju shpërndanë nxënësve një paketë me informacione dhe aktivitete lidhur me ndryshimet klimatike. Në fund nxënësit ndërtuan një terrarium duke e kuptuar më mirë konceptin dhe funksionin e tij.

## 22 maj 2024, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Specialistët e AdZM-së Dibër realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9 – vjeçare “Shemsi Haka” në kuadër të ditës botërore të biodiversitetit. Me anë të lojërave edukative në natyrë, nxënësit mësuuan më shumë rreth biodiversitetit dhe se si duhet ta mbrojmë atë. Aktiviteti ishte mjaft interesant dhe tërhoqi vëmendjen e nxënësve të klasave të ndryshme.

## 23 maj 2024, të njohim breshkat e tokës

Në kërkim të breshkave ishte tema e aktivitetit që u realizua nga specialistët e AdZM-së Dibër në kuadër të ditës botërore të breshkave. Fëmijët e apasionuar pas natyrës u njohën nga afër me breshkat e tokës. Specialistët i informuan mbi dimorfizmin gjinor të breshkave si dhe me rreziqet që hasin breshkat gjatë jetës së tyre.

Pelikani kaçurrel shpendë shtegtarë

ndryshime klimatike biodiversiteti dimorfizmi gjinor

# “EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



## 15 maj 2024, orë mjedisore në "Kanionet e Osumit"

U zhvillua një orë edukimi mjedisor në bashkëpunim me Organizatën EcoAlbania dhe nxënësit e klasës së 6-të të shkollës 9-vjeçare "Zylyftar Veleshnja" Skrapar. Në kuadër të "Ditës Botërore të Ndryshimit të Klimës" të gjithë së bashku vizituan nga afër monumentin e natyrës "Kanionet e Osumit, realizuam një aksion pastrimi në zonë dhe folëm mbi ndikimet e veprimtarisë njerëzore në mjedis dhe klimë.

## 22 maj 2024, "Ne kërkim të biodiversitetit"

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit specialistët e AdZM-së Berat zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 7-të të shkollës 9-vjeçare "Zihni Toska". Së bashku me nxënësit diskutuam mbi rëndësinë që ka biodiversiteti, larmishmërinë e llojeve dhe faktorët e ndryshëm që ndikojnë në shkatërrimin e tij si dhe çfarë duhet të bëjmë në parandalimin e këtij fenomeni. Në përfundim realizuam me nxënësit një ilustrim konkret "Ne kërkim të biodiversitetit".

## 27 maj 2024, resurset e Parkut Kombëtar "Mali i Tomorrit"

Në kuadër të Ditës Evropiane të Parqeve, specialistët e AdZM-së Berat realizuan një orë edukimi mjedisor me nxënësit e klasës së 7-të të shkollës "Xhemal Çekini" Uznovë. Nxënësit u njohën me rëndësinë e parqeve kombëtar, vlerat dhe resurset e shumta që Parku Kombëtar "Mali i Tomorrit" ofron, biodiversitetin e pasur si dhe mënyrat e monitorimit të florës dhe faunës në park.

aksion pastrimi    veprimtari njerëzore    resurse natyrore

larmishmëri llojesh    monitorimi i florës dhe faunës

# “EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



## 02 maj 2024, aktivitete në natyrë

Së bashku me nxënës të shkollës 9-vjecare “Adem Gjeli”, realizuam një aktivitet ndërgjegjësues. Nxënësit u njohën me vlerat e parkut dhe më pas zhvilluan aktivitete argëtuese në natyrë.

## 07 maj 2024, në natyrë me nxënësit e shkollës “Raman Subashi”

Së bashku me nxënës nga Shkolla “Raman Subashi” Marikaj, zhvilluam aktivitet ndërgjegjësues mjedisor në qendrën e vizitorëve. Fillimisht nxënësve iu transmetua informacioni mbi vlerat e Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta” dhe më pas përmes shtigjeve të parkut realizuam vizitë në terren.

## 08 maj 2024, aktivitete me nxënësit e shkollës “Numani”

Të shumta janë shkollat që zgjedhin Parkun Kombëtar “Divjakë-Karavasta” për vizitë. Nxënës nga shkolla jopublike “Numani” Fier me ndihmën e specialistëve të AdZM-së Fier zhvilluan aktivitete të shumta në natyrë. Nxënësit u njohën me vlerat e parkut, u njohën me pelikanin kaçurrel, simbolin e parkut dhe më pas zhvilluan vizitë në terren.

## 10 maj 2024, Dita Kombëtare e Pelikanit Kaçurrel

Kremtuam Ditën Kombëtare të Pelikanit Kaçurrel në Parkun Kombëtarë “Divjakë-Karavasta”, me nxënës të shkollës së mesme “Çermë-Sektor” dhe specialistë nga AOS. Ndamë informacione dhe kuriozitete mbi këtë specie kaq emblematike dhe njëkohësisht simbol i parkut. Aktivitetin e zhvilluam në ekosistemin më të rëndësishëm në Lagunën e Karavastasë, pranë ishullit ku folezojnë Pelikanët (në distancë pa e shqetësuar koloninë). Ishte mbreslënëse pasi nxënësit vëzhguan nga afër pelikanët e rinj, të cilët për pak javë do të jenë të aftë të fluturojnë dhe të largohen nga ishulli. Ky vit ishte i mbarë me 67 fole riprodhuese duke dhënë 54 zogj të rinj, falë monitorimeve të zhvilluara me rigorozitet nga AdZM Fier dhe qetësisë së mundësuar në zonë.

aktivitet ndërgjegjësues

pelikani kaçurrel vizitë në park

## **12 maj 2024, fundjava në Parkun Kombëtar "Divjakë-Karavasta"**

Çdo ditë dhe veçanërisht në fundjavë Parku Kombëtar "Divjakë-Karavasta" frekuentohet shumë nga vizitorë vendas dhe të huaj. Stafi i AdZM-së Fier ndodhet çdo ditë aty për menaxhuar në mënyrën e duhur dhe për të përçuar tek çdo vizitor informacion për vlerat e parkut.

---

## **16 maj 2024, aktivitet në natyrë me nxënësit e shkollës "Shaqe Mazreku"**

Të shumta janë shkollat që zgjedhin për vizitë Parkun Kombëtar "Divjakë-Karavasta". Nxënës nga shkolla 9-vjeçare "Shaqe Mazreku" me ndihmën e specialistëve të AdZM-së Fier zhvilluan aktivitete në natyrë. Nxënësit u njohën me vlerat e parkut, njohën pelikanin kaçurrel simbolin e parkut tonë dhe, më pas zhvilluan vizitë në terren.

---

## **18 maj 2024, aksion pastrimi në parkun e pishave Darzezë**

Specialistët e AdZM-së Fier së bashku me vullnetarët e Korpusit të Vullnetarëve realizuan një aksion pastrimi në një pjesë të parkut të pishave në Darzezë. Shumë mbetje të lëna nga vizitorë që kanë frekuentuar pyllin, u pastruan duke e rikthyer atë në gjendjen e duhur; për të shijuar freskinë, ajrin e pastër dhe peizazhin e bukur që ky park ofron.

---

## **18 maj 2024, vizitë në Parkun Kombëtar "Divjakë - Karavasta"**

Nxënës të shkollave nga çdo skaj i vendit si Shkodra, Tirana, Durrësi, Tepelena e shumë qytete të tjera vizituan Parkun Kombëtar "Divjakë- Karavasta" në datën 18 maj. Ata ishin në Qendrën e Vizitorëve, kullën 360°, në shtigjet e parkut dhe në zonat e pushimit, duke kaluar të gjithë ditën në park.

---

## **19 maj 2024, nxënës nga Elbasani, Kamza dhe Tiranë në "Divjakë-Karavasta"**

Nxënës nga shkollat e qyteteve të Tiranës, Elbasanit dhe Kamëz, vizituan ditën e sotme Parkun Kombëtar "Divjakë-Karavasta". Vizituan qendrën e vizitorëve, shtigjet e parkut dhe pranë zonave të pushimit kaluan një ditë të këndshme dhe të gjatë.

---

## **22 maj 2024, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit**

AdZM Fier në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit zhvilloi një aktivitet pastrimi me nxënësit e shkollës 9- vjeçare "Mizë", në Parkun Kombëtar "Divjakë- Karavasta", si dhe vrojtuan pelikanët kaçurrel dhe shpendët në Lagunën e Karavastasë.

---

## **22 maj 2024, vizita në park nga shkolla "Arbëria"**

Nxënës nga shkolla 9-vjeçare "Arbëria" Kamëz vizituan Parkun Kombëtar "Divjakë-Karavasta". Ata vizituan qendrën e vizitorëve, si dhe u informuan për pasuritë e parkut, veçoritë dhe pasuritë natyrore; në përfundim vrojtuan pelikanin kaçurrel.

---

## **30 maj 2024, aktivitet pastrim në "Dushkaja e Senës"**

Së bashku me nxënësit e shkollës së mesme "Koli Allkanjari" Këmishtaj, zhvilluam një aktivitet pastrimi në Monumentin e Natyrës "Dushkaja e Senës". Kjo është një zonë e frekuentuar nga vizitorë por edhe me prani të mbetjeve nga aktivitetet e tyre. Tashmë kjo zonë u rikthye përsëri në një zonë të përshtatshme për të pushuar.

---

## **31 maj 2024, vizita në park**

Shkolla Jopublike "Vatra e Dijes" vizituan Parkun Kombëtar "Divjakë-Karavasta". Me ndihmën e specialistëve të AdZM-së Fier u njohën me vlerat e parkut në qendrën e vizitorëve dhe me pas zhvilluan lojëra argëtuese në park.

---



# “EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË



## 21 maj 2024, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Specialistët e AdZM-së Vlorë realizuan një orë mjedisore në kuadër të kësaj dite, së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kafil Malaj” Bishan. Nëpërmjet kësaj ore mjedisore nxënësit u informuan mbi biodiversitetin e zonave të mbrojtura, sfidat me të cilat përballet biodiversiteti në ditët e sotme dhe rëndësinë që ka ruajtja e biodiversitetit. Në përfundim të kësaj ore mjedisore, nxënësit realizuan disa piktura të peizazheve nga lumi Vjosa dhe të gjallesave që jetojnë në këto zona.



lumi Vjosa

biodiversitet

peizazh

# “EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



## 10 maj 2024, Dita Kombëtare e Pelikanit Kaçurrel

Në kuadër të kësaj dite zhvilluam një orë mjedisore me nxënësit ku tematika kryesore ishte pelikani kaçurrel në zonën e Parkut Kombëtar të Prespës. Nxënësit u njohën me veçoritë e këtij shpendi dhe këshilla sesi mund t'i mbrojmë ata dhe habitatet e tyre.

## 15 maj 2024, Dita Botërore e Ndryshimit të Klimës

Specialistët e AdZM-së Korçë zhvilluan një aktivitet me nxënësit e shkollës "Treni" në Ditën Botërore të Ndryshimit të Klimës. Për nxënësit ndamë informacione të rëndësishme mbi ngrohjen globale, ndotjen e mjedisit, prerjet masive të pyjeve dhe efektet negative që ato japin në ndryshimin e klimës.

## 20 maj 2024, Vizitë në Parkun Natyror Gërmenj

Studentët e vitit të 2-të Bachelor të Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, u njohën me Parkun Natyror të Gërmenjit, biodiversitetin e tij dhe shtigjet të cilat mund të vizitohen.

## 22 maj 2024, me studentët pranë "Pisha e Sotir-Radanjit"

Me studentët e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, të cilët janë duke vazhduar praktikat mësimore në Parkun Natyror të Gërmenjit, zhvilluam një orë mjedisore tek Monumenti i Natyrës "Pisha e Sotir-Radanjit". Cilësuam veçoritë e zonës dhe vlerat e saj natyrore.

pelikani kaçurrel

habitat

ngrohje globale

ndotje e mjedisit

breshkat e tokës

## **22 maj 2024, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit**

Në kuadër të kësaj dite me ndihmën e specialistëve të AdZM Korçë, organizuam një orë mjedisore me nxënësit e shkollës "Kozma Gjokë Basho" Pogradec, mbi vlerat e biodiversitetit të rajonit, kryesisht rreth Liqenit të Ohrit. Nxënësit kuptuan se aktiviteti njerëzor është shkaktari kryesor i ndikimit në mjedis ndaj duhet të jemi të ndërgjegjësuar për çdo veprim që kryejmë.

---

## **22 maj 2024, krijojmë duke ripërdorur**

Specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës "Sevasti Qirjazi" në kuadër të kësaj dite ndërkombëtare. Ata u njohën me rëndësinë e biodiversitetit, sfidat me të cilat përballët aktualisht biodiversiteti dhe nga se rrezikohet. Në përfundim u zhvillua një pyetësor i shpejtë për të testuar njohuritë e tyre. Së bashku krijuam habitate brenda kutive të këpucëve, duke ripërdorur materiale të ndryshme.

---

## **22 maj 2024, Dita Botërore e Breshkave të Tokës**

Specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një aktivitet mjaft interesant me nxënësit ku përveç njohurive që përcollëm për breshkat e tokës, krijuam edhe art me material të riciklueshme duke përdorur pjata letre, gota letre, fletë A4, ngjyra, gërvshërë, ngjithës. Të mbrojmë breshkat e tokës, gjallesat e nënës natyrë ishte mesazhi i përçuar tek nxënësit nëpërmjet kësaj ore mjedisore.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



## 08 maj 2024, ekspeditë në natyrë

AdZM Gjirokastër në bashkëpunim me Shkollën e Mesme të Bashkuar "Bularat" ka zhvilluar një eskursion në Parkun Natyror "Sotirë" ku është trajtuar biodiversiteti për kafshët dhe llojet e pemëve, të cilat ndodhen në këtë park. Gjithashtu fëmijët u argëtuan në natyrë me informacion dhe lojëra praktike, të cilat patën si synim vetëdijësimin mbi rëndësinë e njohjes së vetes si pjesë aktive e natyrës.

## 14 maj 2024, Dita Botërore të Shpendëve Shtegtarë

Në kuadër të Ditës Botërore të Shpendëve Shtegtarë, AdZM Gjirokastër realizoi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Nonda Bulka". Përmes vizatimeve dhe lojërave, nxënësit mësuan fakte interesante rreth llojeve të ndryshme të shpendëve shtegtarë.

## 22 maj 2024, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit, AdZM Gjirokastër në bashkëpunim me Qendrën "Xhuzepe Grass" ka zhvilluar një orë të edukimit mjedisor e cila synoi rritjen e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit të çështjeve të biodiversitetit.

## 24 maj 2024, Dita Evropiane e Parqeve

Çdo vit, në 24 maj për të rritur vëmendjen për sa i përket rëndësisë dhe përparësive të të gjitha zonave të mbrojtura, AdZM Gjirokastër zhvilloi një orë të edukimit mjedisor në shkollën "Xhuzepe Grass", Nxënësit u njohën me parqet dhe zonat e mbrojtura të cilat kanë një mision të rëndësishëm për të lidhur njerëzit me natyrën. Parqet jo vetëm që të mbrojnë burimet tona të vlefshme natyrore, por ato japin edhe rezultate pozitive shëndetësore. Kontakti me natyrën është thelbësor për shëndetin e njeriut; në një Evropë gjithnjë e më të urbanizuar, ne duhet të krijojmë më shumë mundësi që qytetarët të lidhen dhe të eksplorojnë ambientet jurbane. Kontakti pozitiv me natyrën është vërtetuar se krijon mirëqenie dhe promovon stilin e jetës aktive.

mësim praktikë

vizatime dhe lojëra

kontakti me natyrën

vetëdije

shpend shtegtarë

